



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: BO"V.A.S Konstruktion"sh.p.k&"Beis" sh.p.k&"Meteo" sh.p.k

Adresa: Tiranë, Rruga "Gjin Bue Shpata", pallati "Binjakët", hyrja 1, kati 5, ap.14/1& Kukës Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr. 1 & Elbasan Pishaj Çekin, Fshati " Çekin ", Rruga Nacionale Gramsh-Elbasan,ndërtesë private,Zona kadastrale Nr. 1362,nr.pasurie 6/76,prane Uzinës.

Lloji i procedurës se prokurimit: "Tender – i Hapur".

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Ndërtim rrjet kanalizimi Rruga e Durrësit"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-54326-03-12-2020.

Fondi limit: 144.987.028,00 (njëqind e dyzetë e katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëzetë e tetë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 4 muaj duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 27/04/2020 Ora: 11:00

Buletini i Njoftimeve Publike:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Caushi/M" sh.p.k

NIPT-i L884198010

Vlera 0(zero)

2. "BO"Sireta 2F sh.p.k

&

Alko Impex General Construction sh.p.k

K51501008J

&

K91326028I

Vlera 95,555,555(nëntëdhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.

3. Desaret Company sh.p.k

K01816001J

Vlera 101,203,234(njëqind e një milion e dyqind e tre mijë e dyqind e tridhjetë e katër)lekë pa tvsh.

4. Fusha sh.p.k

J61922018S

Vlera 108,694,444(njëqind e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e katër)lekë pa tvsh.

5. BO"V.A.S Konstruksion"sh.p.k

&

"Beis" sh.p.k

&

"Meteo" sh.p.k

L61322023P

&

K71412003A

&

L26310801C

Vlera 113,715,031,5(njëqind e trembëdhjetë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë e mijë e tridhjetë e një presje pesë) lekë pa tvsh.

6. BO"Sterkaj sh.p.k

&

Arjeil sh.p.k

K31320002C

&

J68310708M

Vlera 119.204.683.5(njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre presje pesë)lekë pa tvsh.

7. Gjiguria sh.p.k

J62903456H

Vlera 130.503.461(njëqind e tridhjetë milion e pesëqind e tri mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një)lekë pa tvsh.

8. BO"Everest" sh.p.k

&

"Arbtrans 2010" sh.p.k

&

"Kronos Konstruksion" sh.p.k

J783111921L

&

L02325001T

&

K41416033P

Vlera 131.790.334(njëqind e tridhjetë e një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e katër)lekë pa tvsh.

9. Kthella sh.p.k

J69303023D

Vlera 131,805,301(njëqind e tridhjetë e një milion e tetëqind e pesë mijë e treqind e një)lekë pa tvsh.

10.BO" Bami"sh.p.k

&

"Egland" sh.p.k

Vlera 133.391.918.1(njëqind e tridhjetë e tre milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë presje një)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë:

1. Caushi/M" sh.p.k

NIPT-i

L88419801O

Vlera 0(zero)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

2. BO”Sireta 2F sh.p.k	&	Alko Impex General Construction sh.p.k
K51501008J	&	K91326028J

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 15 si më poshtë vijon:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	4copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionvetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	6 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine(kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera

Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 150 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në sistemin elektronik të app-së vëren se:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marreveshje për bashkimin e operatoreve ekonomik me nr.1566 rep nr. Kol 1403 datë 24.04.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërive Sireta 2F sh.p.k &”Alko Impex” sh.p.k

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit “ Ndërtim Rrjet Kanalizimi Rruga e

Durrësit si dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë si më poshtë cituar:

- Operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k ka marrë përsipër 55,28%
- Operatori ekonomik Alko Impex sh.p.k ka marrë përsipër 44,72%.

Një ndër operatorët ekonomikë Sireta 2F sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10(mbi disponimin e makinerive) se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa AA084RV me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,9 ton.
- Kamion me targa AA122XY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24,8 ton .
- Rimorkio me targa AA354UB për të cilën konstatohet se në lejen e qarkullimit për mjetin e sipërcituar rezulton të jetë tërheqës dhe jo mjet kamion sic është kërkuar nga AK .

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik Sireta 2 F sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit tërheqës.Gjithashtun KVO vëren se edhe çertifikata për transport mallrash nr.002,datë 16.01.2020 shprehimisht është lëshuar për llojin e mjetit tërheqës.

Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA354UB do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

- Kamion me targa AA548NX me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,9 ton mjet i llojit për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit ATV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rrugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma speciale që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik Sireta 2 F sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit ATV.Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA548NX do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

- Mjeti me targa AA584XD kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit 10,4 ton për të cilën konstatohet se në lejen e qarkullimit për mjetin e sipërcituar rezulton të jetë tërheqës dhe jo mjet kamion sic është kërkuar nga AK .

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik Sireta 2 F sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit tërheqës.

-Mjeti me targa AFR 898 për të cilën evidentohet se operatori ekonomik e ka deklaruar në shtojcën 10 të makinerive por që nuk rezulton të ketë paraqitur dokumentacion shoqërues si leje qarkullimi etj kriteret të kërkuara në DST.

-Mjeti me targa AGR241 kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit 26,9 ton.

Gjithashtu operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10 të makinerive mjetet e

mëposhtme:

- Kamion me targa AA586IC për të cilët evidentohet se operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni shoqërues ashtu siç është kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit.
- Kamion me targa AA698MZ me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,1 ton.
- Kamion me targa AA711HJ me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17,5 ton.(Pavarësisht faktit se mjeti i sipërcituar është mbi tonazhin e kërkuar nga AK ky mjet do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve min 12 ton – 17 ton.
- Mjetin me targa AA715XY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 6,8 ton , për të cilën rezulton se në lejen e qarkullimit është lloji i mjetit ATV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rrugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.
- Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik Sireta 2 F sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit ATV.Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA715XY do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pasaktë.

- Mjetin me targa AA735PY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,9 ton për të cilët evidentohet se polica e sigurimit ka skaduar më datë 13.03.2020.
- Mjetin me targa AA744XB me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0,7 ton.
- Mjetin me targa AA791GK me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,7 ton për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit APV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika g)të Kodit Rrugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në: g) automjet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamionçinë ndërsa operatori ekonomik Sireta 2 F sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit APV.

Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA791GK do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

- Mjetin me targa AA798CP me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 6,65 ton.
- Mjetin me targa AA823XN me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5 ton (mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 3,5 ton- 5 ton).

- Mjetin me targa AA961BV me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 6,7 ton.
- Mjetin me targa AA392CU me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,65 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 04.03.2019)
- Mjetin me targa AA842MX me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,66 ton.
- Mjetin me targa AA102SK me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 02.04.2020)
- Mjetin me targa AA223OG me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,55 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 02.04.2020)
- Mjetin me targa AA385GG me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 27,6 ton.
- Mjetin me targa AA788ND me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16,3 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 02.04.2020)
- Mjetin me targa AA029KE me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16,5ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 17.04.2020)
- Mjetin me targa AA423EZ me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5,2ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 17.04.2020). Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të kërkuar në DST evidentohet se operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST.
- Mjetin me targa AA823GX me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,4 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 17.04.2020). Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të kërkuar në DST evidentohet se operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST.
- Mjeti me targa AA973AH me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,4 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 17.04.2020).
- Mjeti me targa TR0125357(TR7592S) me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,23 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 17.04.2020).
- Mjeti me targa TR2930P me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 17.04.2020) certifikate per llog te vet.
- Mjeti me targa DR6762D me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2 ton (mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 1,5-2 ton)
- Mjeti me targa DR3821D me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,6 ton (mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 1,5-2 ton)
- Mjeti me targa AA516BH me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton (mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 1,5-2 ton)

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat për mjetet e mësipërme përkatësisht mjetin me targa AA392CU me numër çertifikate nr.115, datë 13.09.2018 ,mjetin me targa AA102SK me numër çertifikate 245, datë 21.06.2019 ,për mjetin me targa AA223OG me numër

çertifikate nr.2461 datë 21.06.2019,mjetin me targa AA788ND me numër çertifikate 244,datë 21.06.2019,mjetin me targa AA029KE me numër çertifikate 3129/4 datë 14.10.2016 ,mjetin me targa AA973AH me numër çertifikate nr.19097/1 datë 21.06.2016,mjetin me targa TR0125357TR2592S) me numër çertifikate nr.38192,datë 13.12.2016,mjetin me targa TR2930P me numër çertifikate nr.16931,datë 25.05.2016 janë të lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10(mbi disponimin e makinerive) se disponon mjetet e mëposhtme:

- Mjetin me targa AA589 MS me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3 ton.

- Mjetin me targa AA394ZI me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.4 ton (mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 3.5-5 ton).

- Mjetin me targa AA635YP me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3.2 ton.

- Mjetin me targa AA537TI me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.5 ton.

- Mjetin me targa AA792 PY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2.9 ton.

- Mjetin me targa AA448OE me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8.3 ton.

Mjetin me targa AA014ST për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit APV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rrugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit APV.Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA014ST do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur foto ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA785 YT me kapacitet mbajtës 11.6 ton, për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit ATV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rrugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me

përfshirje të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit ATV.Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA785YT do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA786YT me kapacitet mbajtës 12.5 ton, për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit ATV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përfshirje të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit ATV.Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA786YT do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA633PB me kapacitet mbajtës 12.5 ton, për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit APV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përfshirje të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit APV.Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA633PBdo të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA634PB me kapacitet mbajtës 12.5ton, për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit APV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përfshirje të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti

i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit APV. Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA634PB do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm. Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA864SD me kapacitet mbajtës 11.6 ton, për të cilën në lejen e qarkullimit rezulton lloji i mjetit APV. Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika f të Kodit Rugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në: ; f) automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit APV. Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa AA864SD do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm. Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA391 ZI me kapacitet mbajtës 12.2 ton,

Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

Mjetin me targa AA875XI me kapacitet mbajtës 11.4ton,

Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST , si dhe nuk ka paraqitur foto si dhe cert ashtu dhe sic kërkohet në dokumentat standarte të tenderit.

-Mjetin me targa AA449OE me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,9 ton vlen të theksohet se i njëjti mjet me të njëjtën targë dhe konkretisht AA449OE është paraqitur në shtojcën e mjeteve për të njëjtën procedurë nga operatori “ARB Trans si dhe rezulton se është mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë të përpiluar pranë noterit dhe mban nr 8756 rep dhe 6181kol , kontratë kjo e lidhur më datën 5.10.2018 dhe me afat përfundimi më datën 4.10.2020. Në këtë kontratë pala qeradhënëse është shoqëria Alko-Impex General Construction. Sa më sipër cituar në momentin kur mjeti është dhënë me qera nëpërmjet një kontrate të rregullt shoqëria Alko Impex nuk e disponon për periudhën e kërkuar nga AK. Gjithashtu shoqëria Alko Impex nuk ka

paraqitur ne sistemin elektronik prova që të demostrojne që mjeti nuk rezulton në përdorim të shoqërisë Arb Trans shpk.

-Mjetin me targa AA047 KM me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.5 ton vlen të theksohet se i njëjti mjet me të njëjtën targë dhe konkretisht AA047KM është paraqitur në shtojcën e mjeteve për të njëjtën procedurë nga operatori “ARB Trans si dhe rezulton se është mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë të përpiluar pranë noterit dhe mban nr 8397 rep dhe 5817kol , kontratë kjo e lidhur më datën 22.09.2018 dhe me afat përfundimi më datën 21.09.2020. Në këtë kontratë pala qeradhënëse është shoqëria Alko-Impex General Construction. Sa më sipër cituar në momentin kur mjeti është dhënë me qera nëpërmjet një kontrate të rregullt shoqëria Alko Impex nuk e disponon për periudhën e kërkuar nga AK. Gjithashtu shoqëria Alko Impex nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik prova që të demostrojne që mjeti nuk rezulton në përdorim të shoqërisë Arb Trans shpk.

-Mjetin me targa AA618GM me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.65 ton vlen të theksohet se i njëjti mjet me të njëjtën targë dhe konkretisht AA047KM është paraqitur në shtojcën e mjeteve për të njëjtën procedurë nga operatori “ARB Trans si dhe rezulton se është mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë të përpiluar pranë noterit dhe mban nr 8397 rep dhe 5817kol , kontratë kjo e lidhur më datën 22.09.2018 dhe me afat përfundimi më datën 21.09.2020. Në këtë kontratë pala qeradhënëse është shoqëria Alko-Impex General Construction. Sa më sipër cituar në momentin kur mjeti është dhënë me qera nëpërmjet një kontrate të rregullt shoqëria Alko Impex nuk e disponon për periudhën e kërkuar nga AK. Gjithashtu shoqëria Alko Impex nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik prova që të demostrojne që mjeti nuk rezulton në përdorim të shoqërisë Arb Trans shpk.

Mjetin me targa AA675PI me kapacitet mbajtës 1.4ton,

Për mjetin e sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatën për transport për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST

-Mjetin me targa AA586MS me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.55 ton.(mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 1,5- 2ton)

Operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë referuar përqindjes të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit për të realizuar kontratën objekt prokurimi duhej të paraqiste 7 mjete të sakta me tonazhin e kërkuar nga AK si dhe me dokumentacionin e kërkuar.

Operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë referuar përqindjes të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit për të realizuar kontratën objekt prokurimi duhej të paraqiste 6 mjete të sakta me tonazhin e kërkuar nga AK si dhe me dokumentacionin e kërkuar.

Sqarojmë se bashkërisht bashkimi i operatorëve ekonomikë plotësojnë vetëm 7 mjete te sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar nga AK nga 14 mjete të kërkuara në DST dhe konkretisht mjetet e konsideruar saktë nga Autoriteti Kontraktor janë mjetet me targë:

AA711HJ, AA823XN, DR6762D,DR3821D,AA516BH,AA394ZI,AA586MS.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. **Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.** Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 16 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik Sireta 2F sh.p.k & ALKO Impex General Construction sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Së dyti Autoriteti Kontraktor UKT sh.a ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 3 (tre) specialist per montim tubash
- 2 (dy) hidraulik
- 1 (një) saldator
- 1 (një) elektrikist

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

Një ndër operatorët ekonomikë pjesëmarrës Alko Impex General Construction sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST ka paraqitur specialistët e mëposhtëm:

-z. K.SH shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik profesioni IQT(Hidraulik)

- z.A.M shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Hidraulik)

-z.E.S shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Hidraulik)

-z.Xh.D shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Elektriçist)

-z.Z.SH shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Elektriçist)

-z.E.M shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Elektriçist)

-z.M.M shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Elektriçist)

-z.G.B shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(Elektriçist)

-z.B.B shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(saldator)

z.E.SH shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(saldator)

z.H.K shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(saldator)

z.L.T shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(specialist montim tubash)

z.A.M shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(specialist montim tubash)

z.R.M shoqëruar me kontratë pune si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik IQT profesioni(specialist montim tubash)

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marreveshje për bashkimin e operatorëve ekonomik me nr.1566 rep nr. Kol 1403 datë

24.04.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërive Sireta 2F sh.p.k & "Alko Impex" sh.p.k

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit "Ndërtim Rrjet Kanalizimi Rruga e Durrësit si dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë si më poshtë cituar:

- Operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k ka marrë përsipër 55,28%
- Operatori ekonomik Alko Impex sh.p.k ka marrë përsipër 44,72%.

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit "Ndërtim Rrjet Kanalizimi, Rr.Durrësit në të cilën evidentohet se operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k ka marrë përsipër në kapitullin « Rikostruksion Rrjet Ujësjellësi» përkatësisht zërat nr.44,45,46,47,48.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k evidentohet se për specialistët montim tubash z.L.T, z.A.M, z.R.M janë paraqitur vetëm me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

Referuar natyrës të punimeve të marra përsipër për kapitullin e mësipërm operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k duhej të paraqiste specialistë montim tubash të pajisur me dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në pikën 9 të DST.

Vlen të theksohet se zërat e punimeve nr.44,45,46,47,48 që kanë të bëjnë me punimet të cilat realizohen nga specialistë montim tubash operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k duhej të paraqiste specialistë montim tubash me dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në DST.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se.... Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;

e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike ,pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Ne rregullat e prokurimit theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe **paraqesin te plote te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne DT .**

Moplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim.

Në shtojcën 12 shprehimisht parashikohet se.... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim**

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga njëri prej anëtarëve Alko Impex General Construction sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket stafit mbështetës për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë*

pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në shtojcën 12 të DST shprehimisht parashikohet seRastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Alko Impex General Construction sh.p.k lidhur me pikën 9 të DST është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së treti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

3.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencat:

a)Licensë e lëshuar nga QKL për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B).

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marreveshje për bashkimin e operatoreve ekonomik me nr.1566 rep nr. Kol 1403 datë 24.04.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërive Sireta 2F sh.p.k &”Alko Impex” sh.p.k

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit “ Ndërtim Rrjet Kanalizimi Rruga e Durrësit si dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë si më poshtë cituar:

- Operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k ka marrë përsipër 55,28%
- Operatori ekonomik Alko Impex sh.p.k ka marrë përsipër 44,72%.

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit “Ndërtim Rrjet Kanalizimi, Rr.Durrësit në të cilën evidentohet se njëri prej anëtarëve të operatorit ekonomik Sireta 2F sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë punimet në kapitullin «Punime gjërmimi+shtresa rrugore»përkatësisht zërat nr.3, nr.5, nr.16 të preventivit të punimeve objekt prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se Licenca me KOD III.2.B diponohet vetëm nga njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi e konkretisht nga shoqëria “Alko Impex General Construction ” shpk.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit rezulton se anëtari i këtij bashkimi “Sireta 2F ” sh.p.k i cili nuk është i pajisur me Licencën me Kod III.2.B ka marrë përsipër realizimin e zërave të preventivit zëri nr.3 “Skarifikim shtresë asfalti me makineri” zëri nr.5”Prishje Shtrese Çakulli t=15cm me makineri”, zëri nr.16”Prishje Shtrese Betoni”nga të cilat rrjedhimisht do të krijohen mbetje urbane dhe për këtë fakt kërkohet domosdoshmërisht që kriteri lidhur me Licencën me KOD III.2.B lëshuar nga

QKL për objektin e veprimtarisë “Grumbullim, transportim dhe depozitim imbetjeve urbane”, të plotësohet edhe nga operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k .

KVO gjykon se është pikërisht natyra e punimeve që do të realizohen nga shoqëria “Sireta 2F ” shpk të cilat kërkojnë që shoqëria të kryejë edhe grumbullim dhe transportin e mbetjeve urbane, i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction ” sh.p.k & “Sireta 2F” sh.p.k nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për paraqitjen e Licencës me Kod III.2.B është plotësuar vetëm nga njëri prej anëtarëve të këtij bashkimi, përkatësisht Alko Impex General Construction sh.p.k.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

3. Desaret Company sh.p.k

K01816001J

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Më datë 07.05.2020 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik “Desaret Company”sh.p.k me lëndë ”Deklaratë tërheqje” prot hyrës 7486, datë 07.05.2020 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi” Ndërtim rrjet kanalizimi Rruga e Durrësit’.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “**Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.**” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomiklina shpk.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

4. Fusha sh.p.k

J61922018S

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit ,kapaciteti teknik pika 15 si më poshtë cituar:

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pese) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	4copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionvetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	6 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçinë(kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 150 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Certifikatë për transport mallrash

për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jënë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- h) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- i) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- k) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
